

# Anketa Tremujore e Forcave të Punës

## Tremujori III, 2013

### Tiranë, më 21 janar 2014:

Gjatë tremujorit të tretë 2013 sipas vlerësimeve të marra nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) numri i të punësuarve 15-64 vjeç në Shqipëri ishte 928.456 persona. Ndërsa numri i personave të papunë 15-64 vjeç sipas ATFP-së vlerësohet të jetë 188.944 persona.

Shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë pune 15-64 vjeç ishte 16,9 %.

Gjatë tremujorit të tretë 2013 në Shqipëri 58,7 % e popullsisë në moshë pune ishte aktive në tregun e punës, pra e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune. Ndërsa shkalla e punësimit e cila tregon përqindjen e të punësuarve ndaj popullsisë në moshë pune ishte 48,8 %.

Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë ishte 26.9 % ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ishte 14 %.

Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2013 shkalla e papunësisë pësoi një rritje prej 1,1 %.

### Punësimi


Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për femrat ishte 48,9 % ndërsa për meshkujt 69,5 %. Krahasuar me tremujorin e dytë 2013, pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është ulur me rreth 1,5 pikë përqindje, ndërsa pjesëmarrja e meshkujve është ulur me 1 pikë përqindje.

Gjatë tremujorit të tretë 2013 shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ishte 37,4 % ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ky tregues ishte 70,5 %.

Për popullsinë në moshë pune (15-64 vjeç) vihet re një rënie në shkallën e punësimit nga 55.2 % në tremujorin e tretë 2012, në 48,8 % në tremujorin e tretë 2013.

Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç gjatë tremujorit të tretë 2013 shkalla e punësimit ishte 27,4 % ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ky tregues ishte 60,6 %.

Fig. 1 Shkalla e punësimit sipas gjinisë Tr.1/12 - Tr.3/13



Sipas të dhënave të ATFP, vlerësohet se 22 % e të punësuarve në tremujorin e tretë 2013 punuan në sektorin e shërbimeve të tregut (tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave; hotelet dhe restorantet; transportet, magazinimi dhe komunikacioni; ndërmjetësimi monetar dhe financiar; pasuritë e patundshme). Punësimi në sektorin e shërbimeve jo të tregut (administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi shoqëror i detyruar; arsimi; shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale; aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual; shërbime në shtëpi; aktivitete të organizmave ndërkombëtare) përbënte 17 % të punësimit total. Në sektorin e bujqësisë punësimi përbënte 43 % të punësimit total ndërsa sektori i ndërtimit dhe i industrisë përpunuese përbënte përkatësisht 7,9 % dhe 7,5 % të punësimit total.

Nga tremujori i dytë 2013 në tremujorin e tretë 2013, punësimi u ul me 3,1 pikë përqindje. Gjatë tremujorit të tretë 2013 punësimi ka patur një rënie në sektorin e ndërtimit me 4,6 % dhe në sektorin e industrisë përpunuese me 3,1 %.

Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit pararendës, punësimi në sektorin e ndërtimit ka rënë me 18,8 % dhe punësimi në sektorin e shërbimeve të tregut ka rënë me 6,3 %.

Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2012, pati rritje të punësimit në industrinë nxjerrëse (përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit) dhe përpunuese me përkatësisht 34 dhe 3,2 %. Në sektorin e shërbimeve jo të tregut pati një rritje të lehtë me 0,6 %.

Krahasuar me tremujorin e dytë 2013, gjatë tremujorit të tretë 2013 në sektorët e ndërtimit, industrisë nxjerrëse dhe sektorin e shërbimeve jo të tregut pati një rritje të numrit të të punësuarve kundrejt një page me përkatësisht 2, 14 dhe 5 %. Ndërsa në sektorin e industrisë përpunuese numri i të punësuarve kundrejt një page u ul me 2 %.

Gjatë tremujorit të tretë 2013, të punësuarit me pagë përbënin 41,8 % të numrit të të punësuarve gjithsej. Krahasuar me tremujorin e dytë 2013 numri i të punësuarve kundrejt një page u rrit me 2,3 %. Në grupin e të punësuarve kundrejt një page, 59 % e të punësuarve janë meshkuj kundrejt 41 % që janë femra.

Gjatë tremujorit të tretë 2013 të vetëpunësuarit përbënin 25,2 % të punësimit total. Nga grupi i të vetëpunësuarve 5,5 % ishin të vetëpunësuar me të punësuar kundrejt një page, pra ishin punëdhënës.

Gjatë tremujorit të tretë 2013 punëtorët pa pagesë të familjes përbënin 33 % të punësimit total. Tre në pesë të punësuar si punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes ishin femra.


Gjatë tremujorit të tretë 2013, rreth 52 % e femrave të punësuarve ishin të angazhuara në aktivitete bujqësore, 37,5 % në sektorin e shërbimeve dhe 9,4 % në industrinë përpunuese. Ndërsa ndër të punësuarit meshkuj 36 % ishin të punësuar në sektorin e bujqësisë, 40 % në sektorin e shërbimeve, dhe 13,2 % në sektorin e ndërtimit.

### **Papunësia**

Gjatë tremujorit të tretë 2013 vlerësohen të jenë të papunë 188.944 persona. Shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë pune 15-64 vjeç gjatë tremujorit të tretë 2013 vlerësohet 16,9 %. Shkalla e papunësisë afatgjatë ishte 12 %. Shkalla e papunësisë vlerësohet të jetë më e lartë për meshkujt sesa për femrat, përkatësisht 19,3 % dhe 13,7 %.

Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2013 shkalla e papunësisë pësoi një rritje prej 1,1 pikë përqindje.

Fig.2 Shkalla e papunësisë sipas gjinisë Tr.1/12-Tr.3/13



Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë ishte 26,9 % ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ishte 14 %.

Sipas ATFP shumica e të papunëve u drejtohen të afërmeve apo miqve/shokëve për të gjetur një punë (88,6 % e të papunëve). Kjo metodë e kërkimit për punë është e kombinuar dhe me aplikimin direkt tek një punëdhënës (63,6 %) si dhe me vendosjen e lajmërimeve në gazeta, studimin e lajmërimeve për vende të lira pune në gazeta etj.

**Popullsia ekonomikisht jo-aktive**

Gjatë tremujorit të tretë 2013 popullsia e moshës 15-64 vjeç e klasifikuar si ekonomikisht jo-aktive përbënte 41,3 % të popullsisë në moshë pune. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se ishin nxënës/studentë ose në trajnim përbënin 61 % të të rinjve ekonomikisht jo aktivë.

Gjatë tremujorit të tretë 2013, rreth 17 % e popullsisë ekonomikisht jo aktive e moshës 15-64 vjeç ishte duke përmbushur detyrat shtëpiake.

Gjatë tremujorit të tretë 2013, sipas vlerësimeve të ATFP, 16,7 % e popullsisë 15-64 vjeç ekonomikisht jo-aktive deklaruan që nuk po kërkonin punë për arsye se besonin që nuk ka punë të disponueshme.

Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të klasifikuar si të papunë të dekurajuar përbënin 8 % të të rinjve gjithsej.

Ndër të rinjtë 15-29 vjeç ekonomikisht jo aktivë 12,9 % e tyre klasifikohen si të papunë të dekurajuar ndërsa në popullsinë më të rritur të moshës 30-64 vjeç ky grup përbënte 21,3 % të popullsisë ekonomikisht jo-aktive të kësaj grupmoshe.

Nga ATFP rezulton se 11,3 % e popullsisë ekonomikisht jo-aktive të moshës 15-64 vjeç ishin në pension ndërsa pak më shumë se 5.7 % ishin në paaftësi të përhershme.

**Komente**

Nga ana tjetër, për të marrë vlerësime përfaqësuese në nivel prefekturë, INSTAT po planifikon ndryshime metodologjike për anketën e forcave të punës të cilat do të zbatohen duke filluar nga tremujori i dytë 2014. Këto ndryshime janë të lidhura me rritjen graduale të panelit nga 5 040 familje që është aktualisht në 8 000 familje në të gjithë vendin.

Duke marrë në konsideratë kërkesat e përdoruesve, INSTAT do të vërë në dispozicion të tyre të dhënat në nivel mikro të anketave vjetore të forcave të punës për vitet 2007-2011. Këto të dhëna do të vendosen në faqen e web-it të INSTAT-it në datë 15 shkurt 2014.

**Tab. 1 Shkalla e papunësisë Tr.1/12 - Tr.3/13**

Mosha	Gjinia	Tr.1.2012	Tr.2.2012	Tr.3.2012	Tr.4.2012	Tr.1.2013	Tr.2.2013*	Tr.3.2013
15 vjeç e lart	Total	12,9	13,4	13,5	13,9	13,9	15,4	16,5
	Meshkuj	13,8	14,5	14,6	15,0	15,0	17,4	18,8
	Femra	11,8	12,0	12,1	12,4	12,4	12,7	13,4
15-64 vjeç	Total	13,4	13,9	14,0	14,4	14,4	15,8	16,9
	Meshkuj	14,3	15,1	15,1	15,6	15,6	18,1	19,3
	Femra	12,2	12,4	12,6	12,8	12,8	13,0	13,7
15-29 vjeç	Total	22,9	24,1	27,3	26,0	26,0	26,4	26,9
	Meshkuj	23,6	26,4	30,2	29,5	29,5	30,6	30,4
	Femra	21,8	20,4	22,8	20,7	20,7	19,8	21,5
30-64 vjeç	Total	10,0	10,2	9,3	10,5	10,5	12,7	14,0
	Meshkuj	10,6	10,5	9,3	10,5	10,5	13,9	15,8
	Femra	9,2	9,9	9,4	10,4	10,4	11,2	11,8

\* Për shkak të një pasaktësie të konstatuar në të dhënat e e ATFP-së që i referohen tremujorit të dytë të vitit 2013, treguesit e këtij tremujori janë korrigjuar sipas tab. 1, kolona Tr.2.2013.

**Tab. 2 Shkalla e punësimit Tr.1/12 - Tr.3/13**

Mosha	Gjinia	Tr.1.2012	Tr.2.2012	Tr.3.2012	Tr.4.2012	Tr.1.2013	Tr.2.2013*	Tr.3.2013
15 vjeç e lart	Total	52,0	50,5	49,4	48,6	48,6	44,7	43,1
	Meshkuj	58,0	57,0	56,1	55,4	55,4	51,4	49,5
	Femra	46,1	44,0	42,8	41,9	41,9	38,5	37,2
15-64 vjeç	Total	58,8	56,9	55,2	54,5	54,5	50,5	48,8
	Meshkuj	65,1	63,7	62,2	61,6	61,6	57,8	56,0
	Femra	52,6	50,1	48,2	47,3	47,3	43,9	42,2
15-29 vjeç	Total	39,4	37,7	33,2	32,8	32,8	28,0	27,4
	Meshkuj	44,9	42,8	37,5	36,5	36,5	32,8	32,4
	Femra	33,5	32,2	28,7	28,8	28,8	23,4	22,5
30-64 vjeç	Total	69,4	67,6	67,8	66,9	66,9	63,2	60,6
	Meshkuj	76,9	76,1	77,2	76,9	76,9	72,6	69,6
	Femra	62,2	59,4	58,9	57,4	57,4	54,9	52,7

\* Për shkak të një pasaktësie të konstatuar në të dhënat e e ATFP-së që i referohen tremujorit të dytë të vitit 2013, treguesit e këtij tremujori janë korrigjuar sipas tab. 2, kolona Tr.2.2013.

**Tab. 3 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës Tr.1/12 - Tr.3/13**

Mosha	Gjinia	Tr.1.2012	Tr.2.2012	Tr.3.2012	Tr.4.2012	Tr.1.2013	Tr.2.2013 <sup>*</sup>	Tr.3.2013
15 vjeç e lart	Total	59,7	58,3	57,1	56,4	56,4	52,8	51,6
	Meshkuj	67,3	66,7	65,6	65,2	65,2	62,3	60,9
	Femra	52,2	50,0	48,7	47,8	47,8	44,1	43,0
15-64 vjeç	Total	67,9	66,1	64,2	63,6	63,6	60,0	58,7
	Meshkuj	76,0	75,1	73,2	73,0	73,0	70,5	69,5
	Femra	59,9	57,2	55,2	54,3	54,3	50,4	48,9
15-29 vjeç	Total	51,1	49,6	45,7	44,3	44,3	38,1	37,4
	Meshkuj	58,8	58,2	53,7	51,8	51,8	47,3	46,6
	Femra	42,9	40,4	37,1	36,3	36,3	29,2	28,6
30-64 vjeç	Total	77,1	75,3	74,8	74,7	74,7	72,3	70,5
	Meshkuj	86,1	85,0	85,1	85,9	85,9	84,3	82,6
	Femra	68,6	65,9	65,0	64,1	64,1	61,8	59,7

\* Për shkak të një pasaktësie të konstatuar në të dhënat e e ATFP-së që i referohen tremujorit të dytë të vitit 2013, treguesit e këtij tremujori janë korrigjuar sipas tab. 3, kolona Tr.2.2013.

# Metodologjia

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve. Objektivi kryesor i saj është të japë informacion mbi situatën e tregut të punës në Shqipëri i cili përdoret për të hartuar politikat e tregut të punës dhe për vlerësimin e efektshmërisë së tyre, si dhe për të kënaqur nevojat e përdoruesve të statistikave për të dhëna të përditësuara mbi dinamikën e tregut të punës.

Në vitet 2007-2011 Anketa Tremujore e Forcave të Punës është kryer nga INSTAT me periodicitet vjetor. Në vitin 2012, Anketa Tremujore e Forcave të Punës u projektua si një anketë pilot për marrjen e vlerësimeve tremujore për punësimin dhe papunësinë në nivel kombëtar. Nga tremujori i parë 2013 e në vazhdim, INSTAT publikon tregues mbi tregun e punës të vlerësuar bazuar në të dhënat e anketës së forcave të punës me periodicitet tremujor.

Për ATFP përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen ekzaktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së parë. Sipas strukturës panel të përdorur, në çdo tremujor një e pesta e familjeve të zgjedhura janë të reja dhe 80 % e familjeve janë të njëjta. Pra, në çdo tremujor në kampionin e zgjedhur për anketën shtohen 1 008 familje të reja dhe hiqet po i njëjti numër familjesh pasi është intervistuar në 5 tremujorë të njëpasnjëshëm.

Masa e kampionit të zgjedhur për anketim është 5 040 familje për çdo tremujor. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave gjeografike (të zgjedhura në hapin e parë) zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 8 familjesh.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Në familjet e zgjedhura u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart. Pyetësi i ATFP është hartuar me asistencën teknike të EUROSTAT dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet dhe rregulloret e EUROSTAT. Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientët e variacionit të treguesve kryesorë, hartimin e pyetësorit, si dhe me procedurat e peshimit të të dhënave.



Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës, si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkoshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trainim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 % ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar.

Të papunë konsiderohen personat që ishin:

- i) pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi.
- ii) aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës).
- iii) duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifikë për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjensi private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj.
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta
- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, liçenca ose burime financiare

Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.

Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtepiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.